



**AFETARIZMI SI SHKATËRRIM
INDIVIDUAL E SHOQËROR,
TEK HAFIZ ALI KRAJA...**



**UNË THËRRAS PËR
UNIFIKIMIN E PLOTË
NË MESIN E MYSLIMANËVE!**



**VEPRA TË MIRA
NË PAMUNDËSI TË HAXHIT
DHE UMRES**

Viti XIV - Nr. 8 (162),
Gusht, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

NË MBËSHTETJE TË NJË MOTRE, QË S'MA LINDI NANA!



*Hixhabi nuk është izolim, nuk është bunkerizim, nuk është injorancë,
as privim nga jeta, as distancim nga diversiteti në veshje e perceptim
ndaj vetë jetës! Hixhabi është besë shekujsh, frymëzim brezash,
trashëgimi profetike e lidhje me vetë thelbin e fesë dhe adhurimit!*



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Më tërheq jashtë mase personaliteti i Hoxhës së nderuar shkodran, Hafiz Ali Kraja (1898-1974). Shkrimet e tij periodike, sidomos në revistën “Zani i Naltë”, janë objekt studimi për teologët e rinj dhe përtej tyre.

Sot, dua të ndalem tek kritika që i bën Hafiz Ali Kraja, afetarizmit, si një dëm i madh individual dhe rrezik ekstrem për shoqërinë.


Duke parë degradimin e realiteteve shqiptare, si pasojë e politikave afetare dhe islamofobe, si dhe deformimin e shumë koncepteve mbi fenë, moralin, demokracinë, lirinë, drejtësinë, paqen, harmoninë, trashëgiminë shpirtërore e kulturore etj, mendoj se fjalët e Hoxhës së nderuar, vazhdojnë të jenë akoma në koherencë me këto zhvillime për kombin dhe të ardhmen e tij!

Kjo do të thotë se detyra e muslimanëve shqiptarë karshi fesë dhe kombit të tyre është shumë më e madhe, sesa izolimi në jetën e xhamisë, fetarizmi i fjetur e i rëndomtë dhe partishmëria parazite ndaj erërave të ndryshme, që fryjnë sa andej-këndej, pa pasur paraprakisht një bosht të mirëfilltë strategjik dhe një shtyllë kurrizore identitare!

“Besimi mban rregullimin dhe harmoninë e shoqërisë njerëzore. Shoqëria paraqet një trup, pjesëtarët e të cilit janë në harmoni me atë vend ku respektohen rregullat e moralit. Në pikëpamje morale, kjo harmoni e ka burimin në përbashkësinë e ndjenjave, si fetare ashtu edhe të tjera, të personave që përbëjnë shoqërinë. Po ta heqim Besimin prej mjedisit, kjo harmoni shuhet vetvetiu.

...

AFETARIZMI SI SHKATËRRIM INDIVIDUAL E SHOQËROR, TEK HAFIZ ALI KRAJA...



“AFETARIZMI ËSHTË NJË RREZIK SI PËR SHOQËRI ASHTU PËR PJESËTARËT E SAJ QË JANË FETARË. BESIMI, PRA, ËSHTË GURRA E CILA IA BËN TË KËNDSHME JETËN NJERIUT DHE I JEP ATIJ SHPRESA PËR LUMTURI. AI QË ËSHTË LARG KËSAJ GURRE ËSHTË FATMJERË DHE SIKUR T’I ZOTËROJË TË GJITHA MJETET MATERIALE QË I DUHEN NË KËTË JETË...”

Afetarizmi është një rrezik si për shoqëri ashtu për pjesëtarët e saj që janë fetarë. Besimi, pra, është gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi. Ai që është larg kësaj gurre është fatmjerë dhe sikur t’i zotërojnë të gjitha mjetet materiale që i duhen në këtë jetë; ai është i mjerë se i mungojnë ndjenjat e larta morale të cilat do ta bënin atë të lumtur.

...

Afetarizmi nuk është vetëm një mjet shkatërrues për veten dhe për shoqërinë, por njëherazi edhe për familjen. Vetëm interesi e lidh afetarin me familje.

...

Se Besimi është një nevojë për shoqërinë njerëzore dhe se njerëzit pa

Besim nuk mund të jetojnë në formë të shoqërisë, u tregua edhe në manifestimet tragjikomike në kohën e revolucionit të madh francez...

Me të vërtetë, atë ditë që të fiket ideja e Besimit, po atë ditë njerëzimi është plandosur në humnerë të shkatërrimit.” – (Hafiz Ali Kraja, “A duhet Feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, ribotimi i KMSH-së, Tiranë, 2010, f. 18-21. Botimi i parë, Shkodër, 1934.)

Dialogu dhe hapja me tjetrin, mund të ishte një mundësi e mirë e ballafaqimit të mendimeve, ideve, besimeve e vokacioneve të ndryshme shpirtërore e kulturore, në rrugën e qartësimit të interesave të ndershme e të shëndosha kombëtare!

NË MBËSHTETJE TË NJË MOTRE, QË S’MA LINDI NANA!



Me befasi dhe habi të madhe mësova për rastin e djeshëm, ku një motër e jona me hixhab është sulmuar fizikisht nga një kalimtare rruge, diku në Tiranë!

Motrës tonë i shpreh solidaritet, ndërsa kalimtares së rrugës i uroj gjetjen e ekuilibrave mendorë, emocionalë, socialë e mbi të gjitha, ato humanë!

Ky akt i çuditshëm, vjen si pasojë e cytjes dhe frikësimit që i bëjnë masave shqiptare, qarqe të caktuara politike, mediatike e klerikale, ndaj të cilëve duhet të shprehim vetëm neveri e përbuzje, për një mision të djallëzuar kundër vlerave të besimit, harmonisë dhe tolerancës në vendin tonë! Me ta nuk na bashkon asgjë, as kombi, as gjuha, as raca, as origjina njerëzore, sepse njeriu i djallëzuar është devijim genetik nga origjina e shtrenjtë e njeriut normal, që beson në Një Zot, në fenë dhe vlerat e saj, në kombin dhe vlerat e diversitetit dhe respektimit të tyre!

Primitivizmi i këtij akti dhe banaliteti i komenteve plot mllef dhe urrjetje, vërtetojnë më së miri se sa nevojë të madhe ka ky vend dhe kjo shoqëri për udhëzimin e pastër të vlerave islame, për t’u kthyer tek krenaria e shekujve, pas dekadave persekutimi ateist dhe shpërlarje

truri kolektiv!

Mbushja e xhamive nga rinia, po e vërteton se dita-ditës, brezat e rinj shqiptarë po ndahen nga politikat e urrjetjes, dhunës dhe terrorit ateist, atij islamofob dhe afetar, që punojnë pa pushim kundër harmonisë tonë kombëtare, kundër vlerave humane, kundër shenjtërive! Por, rruga është e gjatë, pengesat e shumta dhe, mbi të gjitha, euforia ngelet element vrashtar i vullneteve dhe përpjekjeve të lavdëruara!

Të ngrihem i të gjithë, për ta shpëtuar njeriun e hutuar të kësaj kohe nga sëmundjet e trashëguara, nga urrjetja e akumuluar dhe overdozat mediatike të drogimit kolektiv me islamofobi, hixhabofobi, osmanofobi, humanofobi, por jo vetëm! Është amanet fetar, është borbë kombëtar!

Hixhabi është krenari dhe identiteti përkushtimi i vajzave tona, motrave, nënave, grave, gjysheve e katragjysheve, që ndër shekuj iu përgjigjën thirrjeve të Librave të shenjtë; Zeburit, Teuratit, Inxhilit e Kur’anit, për t’iu përlur Zotit të gjithësisë në adhurim e përkushtim!

Hixhabi nuk është izolim, nuk është bunkerizim, nuk është injorancë, as privim nga jeta, as distancim nga diversiteti në veshje e perceptim ndaj vetë jetës! Hixhabi është besë shekujsh, frymëzim brezash, trashëgimi profetike

MBUSHJA E XHAMIVE
NGA RINIA, PO E VËRTETON SE
DITA-DITËS, BREZAT
E RINJ SHQIPTARË PO NDAHEN
NGA POLITIKAT E URRJETJES,
DHUNËS DHE TERRORIT ATEIST,
ATIJ ISLAMOFOB
DHE AFETAR, QË PUNOJNË
PA PUSHIM KUNDËR
HARMONISË TONË
KOMBËTARE, KUNDËR
VLERAVE HUMANE, KUNDËR
SHENJTËRIVE! POR, RRUGA
ËSHTË E GJATË, PENGESAT
E SHUMTA DHE, MBI TË GJITHA,
EUFORIA NGELET ELEMENT
VRASHTAR I VULLNETEVE
DHE PËRPJEKJEVE
TË LAVDËRUARA!

e lidhje me vetë thelbin e fesë dhe adhurimit!

Cënimi i hixhabit, është veprim që nuk duhet toleruar në asnjë mënyrë dhe për asnjë alibi, sikurse mbetet një abuzim flagrant me shpirtin e vetë trashëgimisë sonë fetare e kombëtare!

Rastet e këtij cënimi xhahil duhen denoncuar pa hezitim dhe duhen refuzuar maksimalisht në të gjitha format legjitime!

Ftoj institucionet tona, që duke nisur nga dita e nesërme të ketë një përkujdesje më të veçantë ndaj çështjeve të femrës muslimane, asaj shqiptare në përgjithësi, duke u fokusuar tek aktivitetet sociale, tribunat informuese, takimet dhe workshopet, që nxisin përkujdesjen ndaj femrës, krijimin e alternativave për edukim, mbrojtje të drejtave legjitime, duke nisur nga e drejta e fesë, besimit dhe shfaqjes së vokacionit shpirtëror e kulturor!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 5 gusht 2016



Sheikh Ahmed Keftaro

UNË THËRRAS PËR UNIFIKIMIN E PLOTË NË MESIN E MUSLIMANËVE!

Njëkohësisht dua të theksoj se, thirrja e unifikimit islam, nuk duhet drejtuar nga eliminimi i medhhebeve juridike islame, pasi ato janë kredo e madhe intelektuale e ymnetit islam!

Bota perëndimore ka divergjencë në njëmijë fytyra; në kulturë, në gjuhë, në etni, në fé etj, por kapet fort pas asaj që konsiderohet si pikë konsensuale, për realizimin e interesave!

Pra, çudia e çudive është me një ymnet, që ka të përbashkët kiblen, adhurimin, Librin e Zotit, traditat e të dërguarit të vet, pastaj nuk gjen rrugët e mjaftueshme drejt realizimit të unifikimit të tij!

E kam deklaruar edhe më parë, në qëndrime të shumta, se jam kundër termit “afirm medhhebeve islame”; sepse afirmimi ndodh në mesin e të larguarve dhe pakësimin e divergjencave në mesin e armiqve!? Dhe, unë ndjej se, kjo gjë nuk përputhet me medhhebet islame, të cilat bien dakort në më shumë se 90% të qëllimeve, objektivave dhe mjeteve të tyre. Unë mendoj se afirmimi, është një fazë e tejkaluar prej kohësh!

Unë thërras për unifikimin e plotë në mesin e muslimanëve, në rrafsh intelektual, edukativ, në ndërtimin e të sotmes dhe të ardhmes, në

krahët e ajetit kur’anor: “Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut, e mos u përçani!” – (Kur’ani, Ali Imran: 123)

Njëkohësisht dua të theksoj se, thirrja e unifikimit islam, nuk duhet drejtuar nga eliminimi i medhhebeve juridike islame, pasi ato janë kredo e madhe intelektuale e ymnetit islam! Ato janë shfaqje prej shfaqjeve të mëshirës së All-llahut të Madhëruar, siç thoshte edhe kalifi i urtë Omer ibn Abdulaziz: “Nuk do të doja që sahabët e Resulull-llahut të mos kishin diversitetet mendimesh! Sikur të mos kishin këtë diversitet, nuk do të ishte kjo hapësirë e gjerë dhe kjo mëshirë!”...

Përktheu nga arabishtja, nga libri i gazetarit Imad Neddaq:

“Esh-Sheikh Ahmed Keftaro jete haddeth”, botimi i dytë,

Damask, 2003, f. 312-313 dhe përshtati në shqip:

Muhamed B. Sytari



Sheikh Muhamed El-Gazali

Vështroja foton e një fëmije dhjetë vjeçar, fitues i një çmimi, sepse kishte përfunduar hifzin (mësimin përmendësh) e Kur’anit Famëlartë dhe kishte perfeksionuar leximin e tij!

E shikoja me vëmendje fytyrën e tij dhe vëreja që shenja çiltërsie e kishin mbuluar! Ndërkohë që unë nuk e fshihja mahnitjen time për memorien e tij observuese me gjithë moshën e re!

E kisha kaluar një gjendje të tillë, sepse e pata mësuar përmendësh Kur’anin në moshën dhjetë vjeçare dhe pas disa muajsh isha regjistruar në Ez’her, pastaj m’u harrua, por më vonë e rimësova e, për këtë, Allahut i qoftë falënderimi.

Nëse ky mësim përmendësh i hershëm ka ndonjë gjurmë, ai është thesar, që përfitojmë prej tij kur të rritemi dhe mburojë që na mbron jetën tonë individuale, ndërsa ky hafiz i brishtë të ketë përfshirë profetësinë përpara duarve të tij¹, e me memorien e mirë që ka të quhet dijetar, kjo jo!

Akoma edhe sot, kur lexoj disa ajete dhe sure, kujtoj mësuesin, që më qëllonte për ndonjë ajet, më linte për ndonjë tjetër dhe më shpërblente për të tjerë!

E, që unë të kuptoja qëllimin e tyre, kjo nuk më shkonte ndër mend! Ishim kaseta të regjistruara vetëm për shkronja.

Tashi pyes veten: A është Kur’ani libër leximi dhe tekst, që mjaftohemi

1. Autori ka për qëllim hadithin e transmetuar nga Pejgamberit (a.s.), i cili thotë: “Kush e mëson Kur’anin ka përfshirë pejgamberllëkun përpara duarve të tij, me një ndryshim se atij nuk i shpallet më” - (shënimi im - L.H.).

KUR’ANI, MES MËSIMIT PËRMENDËSH DHE KUPTIMIT TË TIJ

“Kush është më zullumqar, sesa ai që përkujtohet me ajetet e Zotit të tij, pastaj ia kthen shpinën atyre.

Ne, me të vërtetë, do të hakmerremi ndaj keqbërësve” - (Kur’ani, Sexhde: 22)

prej tij me një lexim kalimtar?

Meditova rreth qëndrimit të muslimanëve ndaj librit të tyre (Kur’anit), pastaj thashë: Sa i ngjan qëndrimit të këtij fëmije dhjetëvjeçar! Sikur kjo botë islame është fëmijë i madh. Ajo në kuvendet e Kur’anit, hap veshët, por është larg dhe jo prezent. Lëviz vetëm valët e dëgjimit, por nuk lëviz shpirtrat, apo shoqëritë, të gjykojnë me të. E ndërkohë që Kur’ani nuk ka zbritur për një gjë të tillë: “Ky është kumtim për njerëzit, që tu tërhiqet vëmendja me të dhe që ta dinë se Ai është Zot i Vetëm dhe që të përkujtojnë të zotët e mendjes!”²

Kur ndizet drita e kuqe e semaforit, makinat qëndrojnë, i nxituari ndalet dhe lëvizjet ndalen. Sa të ndizet ngjyra jeshile, u lejohet të vazhdojnë e të lëvizin!

Kështu vepron edhe urdhëri dhe ndalimi i Kur’anit për njerëzit. Ndërsa të jetë Kur’ani lexim i shkëputur prej shoqërisë, ai ecë në një luginë, e njerëzit lëvizin në një luginë tjetër, atëherë kjo është tragjedi, apo krim, siç na bën të ditur edhe vetë Kur’ani: “Kush është më zullumqar, sesa ai që përkujtohet me ajetet e Zotit të tij, pastaj ia kthen shpinën atyre. Ne, me të vërtetë, do të hakmerremi ndaj keqbërësve.”³

Kur’ani në kohën tonë është i shkëputur prej jetës së përditshme. Ndoshta mund të ketë lidhje me shkencat e sheriatit, apo shkencat gjuhësore, por të ketë lidhje me shkencat e universit, kjo jo! Ky është libër që flet për qiejt dhe tokën e ç’ka në mes tyre, e të mos ketë lidhje me shkencat e biologjisë, kimisë, kafshëve, bimëve, shtresave të tokës dhe shkencave të jetës?!

E të mos ketë lidhje me shkencat e astronomisë dhe hapësirës?!

Baballarët tanë kanë qenë profesorë në këto lëmi, e çfarë ishte ajo gjë që na largoi prej tyre?


Nëse përjasja jonë në këto njohuri (lëmi) është mbështetje e ateizmit dhe largimit prej Zotit, atëherë a kemi qenë të drejtë ndaj vetes dhe ndaj Kur’anit tonë me paaftësinë në artet e jetës dhe studimin e universit? Imani (besimi) në logjikën e Kur’anit ndërtohet mbi vëzhgimin, meditimin dhe zbulimin, e ku qëndron vlера e besimit të shkëputur prej këtyre kuptimeve?

NËSE PËRQASJA JONË NË KËTO NJOHURI (LËMI) ËSHTË MBËSHTETJE E ATEIZMIT DHE LARGIMIT PREJ ZOTIT, ATËHERË A KEMI QENË TË DREJTË NDAJ VETES DHE NDAJ KUR’ANIT TONË ME PAAFTËSINË NË ARTET E JETËS DHE STUDIMIN E UNIVERSIT? IMANI (BESIMI) NË LOGJIKËN E KUR’ANIT NDËRTOHET MBI VËZHGIMIN, MEDITIMIN DHE ZBULIMIN, E KU QËNDRON VLERA E BESIMIT TË SHKËPUTUR PREJ KËTYRE KUPTIMEVE?

Uli kokën dhe hesht, duke qeshur e duke u pikëlluar, kur ndonjë ceremoni çelet me Kur’an, pastaj fytyrat e njerëzve përvëlohen prej dashurisë në çdo lëmi, pa i lidhur asgjë me Librin Famëlartë (Kur’anin) dhe pa depërtuar në zemrat e tyre asnjë rreze...

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

DISA SHPIKJE (BIDATE) TË PRANUARA

1. Gjëja e shpikur në falje: Transmeton Bukhariu se një sahabë kur u printe shokëve të tij në xhaminë e Kubasë, në kohën e Profetit (a.s) ai lexonte kaptinën ose suren “Kulhuvell-lahu ehad”, e disa u mërzhitën sepse ky s’lexonte veçse këtë kaptinë për çdo reqat. I thanë: Pse këndon vetëm atë kaptinë, pse s’këndon një kaptinë tjetër? Ai u tha: “Nuk e ndërroj këtë kaptinë në daçi me ju pri!”. I erdhi lajmi Profetit (a.s), i cili e thirri atë prijës, dhe kur ky erdhi e pyeti Profeti (a.s): “Pse nuk bën çfarë kërkojnë shokët e tu, por i kundërshton?” Ai u përgjigj: Unë e dua shumë këtë sure. Këtu Profeti (a.s) i tha: “Dashnia jote ndaj asaj sureje, do të fusë në Xhennet!”

Ai sahabë, pra, shpiku atë lexim dhe Profeti (a.s) e pranoi dhe, siç dihet, ai lloj leximi në falje nuk është synet.

2. Sendi i shpikur në lutje: Transmeton Bukhariu se Ebu Said El-Khudri (r.a) ishte në një karvan me një sahabë. Arritën në një fshat, kërkuar prej fshatit pak ujë e gjëra që i nevojiteshin atyre si udhëtarë, por ata refuzuan që t’i ndihmonin. Në atë kohë e hëngri akrepi të parin e atij fisi në atë fshat. Dërguan një njeri për të pyetur sahabet: A keni kënd që shëron njeriun që e ha anza apo akrepi? Tha Ebu Saidi: Unë jam, por nuk e vizitoj po s’më dhatë 30 dhen. Ata pranuan. Erdhi Ebu Saidi, i cili ia lexoi suren “Elhamdu-lil-lahi”, me frymë, për 7 herë mandej iu ndal dhembja. I sëmuri u shëndosh, ndërsa sahabët morën dhentë.

Ai që e shëroi me Kur’an tha: Nuk po i presim për t’i ngrënë e as po i ndajmë deri sa të shkojmë te Profeti (a.s) e ta pyesim. Kur erdhën te Profeti (a.s) i treguan se çfarë kishte ndodhur. Këtu, Profeti (a.s) pyeti: “Kush ta tregoi se

BIDATE TË PRANUARA DHE DISA TË TJERA TË REFUZUARA

ai lexim është si ilaç?”. Dhe Ebu Saidi iu përgjigj: “Zoti ma solli në mend, d.m.th. nuk kam mësuar e as nuk kam dëgjuar gjë nga ti”. Këtu Profeti (a.s) i tha: “Mirë keni bërë, ndani ato dhen ndërmjet jush, edhe mua më jepni një hise”. (Muslimi)

Thamë, ky hadith është baza e disave që shkruajnë hajmalia me Kur’an, Hadithe e duana të mira dhe marrin para. Hajmalia me fjalë që nuk lexohen, ato që përmbajnë emrat e disa xhinëve e që kërkojnë prej tyre për të bërë gjë, këto janë hajmalija haram, janë të ndaluara për t’i bërë, as për të marrë para për to. Po ashtu janë haram për të sëmuri ato lloj shkrimesh si dhe dhënia e parave për to.

3. Me u mbledhë e me përmendë Zotin (xh.sh): Transmeton Muslimi se doli hz. Muavija në xhami, ku gjeti një grumbull njerëzish ndenjur. I pyeti: Çfarë iu shtyri me ndejë? Thanë: Ndejëm me përmendë Zotin (xh.sh). Hz. Muavija u përgjigj: Betohem në Zotin (xh.sh), nuk keni qëndruar vetëm se për atë shkak?! Iu betuan se për atë shkak kishin qëndruar. Atëherë u tha: Unë kërkoja benë tuaj jo se ju akuzova, mbasi unë jam më i pakti ndër ju në hadithin e Profetit (a.s), por një herë Profeti (a.s) erdhi në xhami dhe pau një grumbull sahabësh, të cilët i pyeti: “Pse janë mbledhur e kanë qëndruar bashkë?”. Iu përgjigjën: “Kemi qëndruar për të përmendur Zotin (xh.sh) e me e lavdëru për udhëzimin tonë në këtë fe Islame”. Profeti (a.s) i tha: “A për këtë shkak jeni mbledhur me ndejë?”. Dhe ata thanë: “Betohemi se për atë gjë jemi mbledhur!”

Profeti (a.s) tha: “Unë nuk kërkoja betimin nga ju se ju akuzoj, por më erdhi Xhibrili e më tregoi se Zoti (xh.sh) mburret me ju përpara melekëve”.

Unë them me u mbledhë me xhematë, me përmendë Zotin (xh.sh) duke thënë çfarë duhet, nga fjalët e ardhura në Kur’an, në Hadith e me rëndësi, e me qëndruar me edukatë, por jo me thënë çfarë nuk duhet, p.sh. me thënë në vend të fjalës ALLAH, (emri i madh i Zotit), me thanë: “Eh”, “Ah”, etj. Mos me lexu disa fjalë që nuk i dimë në fe, siç bëjnë disa të shkretë këtu, që e përcjellin atë gënjeshtëri që thotë me lexu njëlloj salavatit, që s’e ka përmendur Profeti

(a.s) as sahabët e mëdhenj, bile edhe nuk është njohur deri përpara 200 vjetëve, që quhet SALAVATI EL-FATIH.

E thonë disa të shkretë se, leximi i atij salavati, është më mirë se leximi i Kur’anit 6000 herë. A ka gënjeshtëri më të madhe se kjo? Si mundet me kenë fjala e robit më e mirë se fjala e Zotit? Si mundet me qenë kaq e vlefshme kjo fjalë e mos me ia tregu Profeti (a.s) askujt këtë fjalë, i cili ka punuar për të mirën e njerëzisë? Si mundet me pasë revelatë një njeri mbas Profetit (a.s) me thënë këto fjalë, mbasi besimi i jonë është se mbas Profetit Muhammed (a.s) nuk ka Profet tjetër dhe se revelata është ndërprerë me ndërrimin e jetës së Profetit (a.s)? Është mëkat i keq me kërcy, me u shkapetë në mur e në tokë, duke bërë gjoja Dhikër.

Shkurtimisht mbledhja për përmendjen e Zotit dhe lavdërimi i Tij me dhikër, me mësim e me lexim të Kur’anit, me ilahina të zgjedhura, me përmendjen e jetës së Profetit (a.s), me këndimin e Meuludit, është e mirë pasi përmendet në hadith. Por mos me nderu ndejën në xhami, me thanë çfarë nuk pranon feja, me u sjellë si nuk pranon feja, ato janë të ndaluara se nuk lidhen me kushtet e shtyllat e fesë dhe quhen Bidat, Dalalet e humbje. Mos të harrojmë se Dhikri sido me qenë bëhet në këmbë, ndenjur, ratë, në rrugë, në shtëpi, kurse me e lanë faljen e agjërimin e shumë të mira, mandej me u mbledhë për dhikër, ajo quhet lojë me fe e s’ka lidhje me të, mbasi lihen farzet e fesë, bëhen disa harame deri edhe pirje alkooli, siç thuhet për disa të sharrur këtu.

Transmeton Ebu Davudi e të tjerë nga hz. Enesi, thotë: Isha ndenjur me Profetin (a.s) e disa njerëz në xhami, ku ishte një burrë që po u falte, kur ai ra në ruku e sexhde mandej ndejti e këndoi “Et-Tehijati”, u lut e tha: O Zoti i jem, unë të lutem se lavdia është për ty, s’ka zot përveç Teje, Ti je Shpikësi i qiejve dhe i tokës, i Madhnueshëm, Bamiërës, i Gjallë, Mbikëqyrës, i Përhershëm. Këtu Profeti (a.s) tha: “Ky sahabë iu lut Zotit (xh.sh), me emrin e Tij (xh.sh) më të madh, me të cilin kush e thërret i përgjigjet dhe kush i kërkon me këtë emër i jepet kërkesa.”

Them: Kjo punë e atij sahabë na

mëson një gjë të nevojshme se duhet të kërkojmë prej Zotit (xh.sh) të bëjmë dua edhe me fjalë që i shpikë njeriu nga vetja e tij, mbasi janë brenda kufirit të fesë. Me të vërtetë më mirë është me përmendë duanat e Kur’anit e Hadithit se janë padyshim të pranuar fetarisht e më të sigurta, mirëpo shumë njerëz nuk dinë shumë duana arabisht atëherë duhet me i ba duanat në gjuhën tonë të ëmbël.

Transmeton Ebu Davudi edhe të tjerë nga Amr ibn Asî, se kur e dërgoi Profeti (a.s) në betejën e quajtur “Beteja e zinxhirëve”, ai kur fjeti në një natë të ftohtë e mërdhiti në të e u bë për me u la, thotë: U frikësova me u la mos po ftohem e dëmtohem, prandaj bëra tejemmum, mandej u fala imam faljen e sabahut. Kur u ktheva në Medinën e Ndrishme, i treguan Profetit (a.s) për atë çfarë më ndodhi mua. Këtu më pyeti Profeti (a.s): “A me të vërtetë je falë imam, duke pasë nevojë me u la?”. Thashë: “Po, e kujtova versetin që thotë: “Mos e mbytni vehten tuaj se Zoti ka mëshirë mbi ju”. Këtu Profeti (a.s) buzëqeshi e nuk tha gjë. Këta shembuj të pakta, të shkurtëra nga vargu i madh i atyre lloj shembujsh na tregojnë se sahabet kanë shpikur disa fjalë e disa sjellje nga vehtja, më vonë Profeti (a.s) i ka pëlqyer mbasi ato janë mbrenda kushteve fetare.

DISA SHPIKJE (BIDATE) TË REFUZUARA

1. Na transmeton Buhariu se, hz. Abdull-llah ibn Abasi (r.a) ka thënë: “Ndërsa ishte Profeti (a.s) duke dhënë ligjëratë, pau një njeri që qëndronte në këmbë dhe pyeti për të. I thanë që ky është Ebu Israili, i cili është betuar të qëndrojë në këmbë dhe në diell pa u mbuluar në një hije, mos me folë, dhe me agjëru. Këtu Profeti (a.s) tha: “Urdhëronie atë burrë të flasë, të rrijë nën hije, dhe të plotësojë agjërimin”.

Thotë një dijetar hanbeli, Hafizi Ibn Rexheb: “Kush merr me iu afri Zotit (xh.sh) me një punë që nuk e ka thënë Zoti (xh.sh) as Profeti (a.s) si ibadet e adhurim, puna e atij quhet e kotë!”

Pra, Profeti (a.s), ndaloi atë sahabë të bënte disa gjëra, si me qëndru në këmbë, ne diell pa hije, mos me folë dhe e urdhëroi me plotësue agjërimin, se ato punë që i ndaloi nuk përputhen me kushtet e kërkesat e fesë tonë islame.

2. Transmeton Buhariu se, Ebu Xhuhajfe tha: Vëllazëroi Profeti (a.s)

Selmanin me Ebu Derdanë dhe i bëri vëllezër. Një ditë vizitoi Selmani, Ebu Derdanë ku pau gruan e vëllait me rroba jo të rregullta dhe e pyeti: Pse je veshur kështu? I tha: “Vëllau yt Ebu Derdai s’ka nevojë e kërkesë për gruan e tij”. Në këtë kohë erdhi Ebu Derdai dhe mbas pak kohe i nxori për të ngrënë vëllait të vet, Selmanit, e i tha: Ha vetëm, se unë jam agjërueshëm. Selmani iu përgjigj: Unë nuk ha derisa të hash edhe ti, dhe hëngri edhe Ebu Derdai. Kur erdhi koha për të fjetur, Selmani u shtri. Në këtë kohë Ebu Derdai mori me u falë. I tha Selmani: “Fli deri sa të kalojë një pjesë e mirë e natës”. Atëherë u çua Selmani dhe i tha vëllait të vet: “Zgjuhu e falu tashti”- dhe u falën të dy bashkë. Këtu, Selmani i tha: “O vëlla! Zoti ka të drejta dhe kërkesa tek ti, edhe vetja e jote ka të drejta e kërkesa tek ti, edhe gruaja jote ka të drejta dhe kërkesa tek ti, pra jepja secilës nga ato të drejta dhe kërkesa, hakun e saj”. Kur e mësoi këtë gjë Profeti (a.s) tha: “Selmani tha të vërtetën!”

Pra, mbasi feja kërkon prej njeriut me kenë mesatar në jetën e tij e mos me humbë trupin e familjen për hir të shpirtit. E ndaloi Profeti (a.s) besimtarin me e lodhë vehten më shumë se duhet, dhe në qoftë edhe me ibadet, sepse nuk pëlqehet me synetin e atij Zotëri (a.s).

3. Transmeton Ibnu Hibbani nga Ibn Ebi Eufa se ka thanë: Kur u kthy hz. Muadhi (r.a) nga Shami (kur ishte i romakëve), bëri sexhde (vuri ballin në tokë) përpara Profetit (a.s). E pyeti Profeti (a.s) se çfarë është kjo gjë? Muadhi tha: O i dërguari i Zotit (xh.sh), unë erdha nga Shami, ku pashe se njerëzit iu binin në sexhde priftave të tyre, prandaj desha të bëj si ata. Profeti (a.s) tha: “Mos bëj ashtu, se unë me qenë se urdhëroj ndokënd me ra në sexhde para kujt, do të kisha urdhëruar gruan të bëjë sexhde përpara burrit të vet, nuk plotëson gruaja të drejtat e Zotit tek ajo, deri sa t’i japë burrit të saj të drejtat e tija në veten e saj”.

Pra, mbasi sexhde nuk i bëhet kujt tjetër përveç Zotit (xh.sh), as nuk i përkulet kujt përveç Tij, prandaj e ndaloi Profeti (a.s) Muadhin të bënte atë gjë, pasi nuk pajtohej me rregullat e kushtet e fesë Islame.

4. Transmeton Buhariu, e të tjerë, se Beshiri i dha djalit të vet Nu’manit një dhuratë, e fëmijëve të tjerë jo. Gruaja e tij i tha: Nuk më pëlqen kjo sjellja e jote, shko e pyete Profetin (a.s): A bën që babai të veçojë një fëmijë nga të tjerët

UNË THEM ME U MBLEDHË
ME XHEMATË ME PËRMENDË
ZOTIN (XH.SH.) DUKE THËNË
ÇFARË DUHET, NGA FJALËT E
ARDHURA NË KUR’AN,
NË HADITH E ME RËNDËSI,
E ME QËNDRU ME EDUKATË,
POR JO ME THËNË
ÇFARË NUK DUHET.

me diçka, si peshqeshe e dhuratë? Shkoi burri te Profeti (a.s) dhe i tregoi se çfarë kishte bërë. Këtu Profeti (a.s) e pyeti: “A nuk dëshiron ti që fëmijët e tu të jenë me një lloj sjelljeje e bindjeje përpara teje?”. Tha po. “Atëherë pra, -tha Profeti (a.s), - mos i dalloni fëmijët tuaj me diçka nga vëllezërit e motrat e tyre”.

Kështu, Profeti (a.s) ndaloi babain ose nënën me e dallu një fëmijë përveç vëllezërve e motrave të tjera, mbasi kjo gjë ndoshta mbjell zili e keqdashje ndërmjet vëllezërve e motrave; kjo gjë nuk pranohet e nuk pëlqehet në fenë tonë, pra ky qe shkak që dhurata e veçantë ndalohet.

Babai e nëna nuk duhet të dallojnë një fëmijë me përkëdhelje e dashuri të veçantë, se ndoshta ajo sjellje vë në zemrat e vëllezërve të tjerë një armiqësi të vëllezërve kundra tij, e bëjnë siç bënë vëllezërit e Jusufit me vëllain e tyre, siç është përmendur edhe në Kur’an, deshën me e mbyttë e me e nda nga babai i vet.

5. Transmeton Muslimi nga Ibni Abasi se Profeti (a.s) pau një njeri që kishte një unazë ari në gisht. Ai zotëri i zgjati dorën, ku i hoqi unazën nga gishti i atij sahabë, e hodhi larg e tha: “Si merr një njeri prej jush gacën e zjarrit dhe e vë në gishtin e vet”. Kaloi Profeti (a.s) dhe i tha dikush atij sahabë, merre unazën e përfito prej saj. Tha: “Jo, nuk e marr kurrë, mbasi e hodhi Profeti (a.s)”.

Pra, gjëja që është kundër kërkesave të fesë, nuk duhet të bëhet.

Dihet se feja e ndalon mashkullin me e përdorë arin, veç në qoftë për dhëmbë, dhe se feja e ka lejuar femrën të zbukurohet me ar e me u kënaqë me të, por jo me e përdorë si gota, pjata, lugë, etj.



Arben Halluni, teolog

Th uaj robërve të Mi, të cilët besuan: Të falin rregullisht namazin dhe me atë që i furnizua ata, të japin fshehtas e haptas, para se të vijë një ditë, që në të nuk ka as kompensim as miqësi". (Ibrahim, 31)

Allahu (xh.sh) nëpërmjet këtij ajeti kur'anor i drejtohet besimtarëve me një mesazh të mëshirshëm dhe kjo mëshirë shprehet nëpërmjet të dërguarit të Tij, Profetit të fundit të Islamit. Në vahjin apo shpalljen hyjnore është treguar interesimi dhe kujdesi i Krijuesit për robërit e Tij që nëpërmjet punëve të tyre të arrihet maksimumi i kënaqësisë hyjnore.

Robërit e Allahut (njerëzit) duhet të përpiqen që të përfitojnë çdo grimcë të jetës së tyre të kufizuar për të korrur pëlqimin e Allahut (xh.sh) si p.sh: përmes faljes së namazit që është shtylla më kryesore e Islamit, dhënies së lëmoshës fshehtas dhe haptas, besimit në Allahun (xh.sh), ndjenja për të përfutur kohën në çdo moment etj. "E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë". - (Ez-Zelzele: 7-8)

Në këtë mesazh Hyjnor vërehen dy çështje:

E para: Llogaritja e kohës. Pa dyshim Allahu (xh.sh) na ka dhuruar jetën e cila ka fillimin dhe mbarimin. Është e pa dyshuar se besimtari i drejtë ndjen në veten e tij se ai është në garë me këtë fund. Ai përpiket që para saj të regjistrojë sa më shumë nga punët e dobishme për të cilat ka nevojë dhe pa to ai do të ishte fillimi i fundit. "Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vetes

"KOHA ËSHTË SI SHPATA, NË QOFTË SE NUK E PRET, AJO TË PRËT TY"

atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që e bëri, do të dëshirojë që në mes tij dhe në mes të asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë)". - (Ali Imran: 30)

Qëndrimi i njeriut Ditën e Llogarisë është i lidhur me kohën. Njeriu i rregullt do që t'i afrohet Allahut (xh.sh) nëpërmjet veprës së dobishme dhe njëkohësisht shpreson që Krijuesi me mirësinë dhe mëshirën e Tij të pakufishme të bëjë në mes tij (robërit) dhe të keqes një distancë shumë të madhe.

E dyta: Mesazhi Hyjnor ka treguar se nga veprat e mira që i do Allahu Fuqiplohtë është namazi, dhënia e zeqatit e sadakasë etj, t'i sjellin dobi njeriut praktikant Ditën e Gjykimit që në të nuk ka as kompensim dhe as miqësi, por atë ditë njeriu preokupohet se si do t'i dalë shpërblimi apo dënimi, e kjo varet sipas asaj që ka besuar dhe punuar në këtë jetë lëndore dhe të përkohshme.

Kur'ani Famëlartë ka treguar në shumë vende në mënyrë imagjinare dhe në pamje lëndore lidhjen midis krijesës dhe Krijuesit, megjithëse ato faktikisht sillen rreth besimeve dhe vlerave shpirtërore. Nga ajetet më të dalluara për këtë çështje mund të përmendim: "Allahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me xhennet". - (Et-Teube: 111)

Në pamje të parë duket se kjo blerje është e largët, sepse shpërblimi që jep Allahu do të jetë ditën e Kijametit, mirëpo besimtari i drejtë ndjen në thellësitë shpirtërore se shpërblimi në këtë mënyrë do të jetë i afërt, sepse ai me dëshirë dhe vullnet paraqet në zemrën e tij kuptimet e Ahiretit dhe kështu ai ndjen se po paraqitet në takimin me Krijuesin e gjithësisë.

Ky është besim dhe jo iluzion, e vërtetë dhe jo trillim, realitet dhe jo imagjinatë.

Nuk ka dyshim se ndjenja për kohën ndryshon nga një person në një person tjetër ashtu siç ka dallim një popull nga një popull tjetër. Historia nuk ka

Ne si myslimanë jemi të urdhëruar që ta ruajmë dhe ta shfrytëzojmë kohën dhe në të njëjtën kohë të punojmë në llogari të së ardhmes, ashtu siç na mëson besimi ynë islam dhe shembulli i përkryer i të parëve tanë që na kanë lënë për ta aplikuar në çdo aspekt të kësaj jete.

njohur ymmet që ka shenjtëruar dhe madhështuar kohën në kushtetutën e tij si ymmeti i Muhammedit (a.s) për të cilin Allahu (xh.sh) e ka treguar në mënyrë të përkryer nëpërmjet përshkrimit të rregullit të universit "Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontradiktë". - (El-Mulk: 3)

Minutat dhe sekondat në vitet e popujve dhe në jetën e individëve kanë peshë dhe llogari. Orët e gjata realisht nuk janë gjë tjetër vetëm minuta dhe sekonda. Humbja e sekondave është në të vërtetë humbje e atyre orëve të cilat kalojnë me kalimin e moshës së njeriut.

Sa prej orëve, ditëve dhe viteve humbasin në jetën e këtij ymmeti nëpërmjet kafeneve, bareve, klubeve të natës e tjera si këto, që shumë njerëz po vihen në garë se kush preferon lokalet më të shtrenjta, më luksoze dhe më imorale? Sa herë dëgjojmë që një pjesë e madhe njerëzve e humbasin kohën me gjumë, kaos, pasivitet dhe dembelizëm për të punuar?

Në një kohë që shkatërrimtarët e dhunshëm rrinë zgjuar, përfitojnë çdo moment të kohës deri edhe sekondën për hir të fitimit të shkaqeve të



forcës dhe me qëllim për të vendosur terrorin e tyre mbi fatin e njerëzve në përgjithësi. Disa prej nesh bëjnë të kundërtën, humbasin vitet dhe nuk ndjejnë kalimin e tyre, ndërsa kundërshtarët i bëjnë llogari vetes së tyre për çdo sekondë për shkak të frikës se i kalojnë pa rezultat dhe prodhim, sepse koha është pjesë e përparimit dhe zhvillimit të tyre, ashtu siç mund të jetë pjesë e humbjes dhe e dështimit të disa njerëzve që nuk e vlerësojnë kohën dhe nuk përfitojnë prej saj.

Ne si myslimanë jemi të urdhëruar që ta ruajmë dhe ta shfrytëzojmë kohën dhe në të njëjtën kohë të punojmë në llogari të së ardhmes, ashtu siç na mëson besimi ynë islam dhe shembulli i përkryer i të parëve tanë që na kanë lënë për ta aplikuar në çdo aspekt të kësaj jete.

Islami na ka urdhëruar për namaz pesë herë në ditë. Gjithashtu Allahu (xh.sh) ka legjimuaz ezanin për të njoftuar hyrjen e vaktit (kohës) dhe për të treguar fillimin e një obligimi të ri që përsëritet vazhdimisht. Në të njëjtën kohë Allahu (xh.sh) i ka tërhequr vëmendjen besimtarëve që të mos neglizhojnë kryerjen e namazit dhe në rast se e kryejnë në rregull u ka premtuar se do të shpërblehen.

Po ashtu feja islame ka treguar që besimtari të mos humb kohën në biseda të kota dhe pa vlerë. Besimtari i mirë nuk harxhon kohën në llomotitje, por koha e tij është punë dhe vetëm punë permanente dhe frytdhënëse. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: "Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: Ne kemi veprat tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!" - (El-Kasas: 55)


Më këtë edukatë të urtë dhe më këtë llogari të saktë myslimanët e

parë kanë ruajtur fenë e tyre, kanë ngritur vendimet e sheriatit të tyre, kanë vendosur themelet e përparimit të pa krahasuar dhe paraqitën për ne shembëlltyra të sinqerta në të gjitha çështjet: në besim, adhurim, moral, paqe, harmoni dhe mirëkuptim me të gjitha krijesat e Zotit Fuqiplohtë, të cilat nuk i ka njohur historia e njeriut, ngase ishin të parët që vlerësuan kohën dhe e përfutuan atë me anë të adhurimit, sjelljes dhe punës në përgjithësi.

Kështu pra ishin të parët tanë myslimanë, kështu duhet të jemi ne dhe kështu duhet të jenë edhe myslimanët e ardhshëm që e kalojnë kohën me adhurim të vërtetë, me punë të drejtë, prodhim frytdhënës dhe rregull të suksesshëm me anë të cilave ka mirësi ai që e praktikon dhe i gjithë njerëzimi.

Transmetuar nga Ibn Omeri (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Jeto në këtë jetë sikur je mysafir ose udhëtar", Kurse në një rast tjetër ka thënë: "Nëse ngrysesh mos e prit sabahun (mëngjesin) dhe nëse gdhihesh mos e prit darkën. Shfrytëzoje shëndetin përpara sëmundjes dhe jetën përpara vdekjes".

Pra si përfundim, kohën duhet ta shfrytëzojmë, të jemi në paralel me të dhe ta përfitojmë atë në çdo moment. Aq rëndësi i ka dhënë feja islame kohës sa që edhe Allahu (xh.sh) betohet në kohën, pikërisht në suren (kaptinën) "El-Asr", ku në të thuhet: "Pasha kohën. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njeri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njeri-tjetrin të jenë të durueshëm". Ndërsa një fjalë e urtë thotë: "Koha është si shpata, në qoftë se nuk e pret, ajo të pret ty".



"Islami, në të cilin thërrasim, është Islami që ngrihet mbi Akide (Besim), shpirti i saj është Teuhidi (Njëshmëria); Adhurim, shpirti i tij është singëriteti; Moral, shpirti i tij është mirësia; Sheriat, shpirti i tij është drejtësia; Lidhje, shpirti i saj është vëllazëria; dhe fryti i tërë kësaj: Qytetërim, shpirti i tij është ekuilibri dhe integrimi!"

Dr. Jusuf El-Karadawi

NË RITMET E RIMËKËMBJES...

BËRDICË E MESME



KRYEBUSHAT



BËRDICË E MESME



FSHATI I RI, POSTRIBË



KRYEBUSHAT



SHTUF, ANA E MALIT



FSHATI I RI, POSTRIBË



SHTUF, ANA E MALIT





Gëzim Kopani
Myfti i Pukës

Që në zanafillën e saj në periudhën Osmane Puka, e cila në disa raste njihet edhe me emrin Dukagjin ka qenë pjesë e vilajetit të Shkodrës.¹ Rrethina e Pukës u quajt Kaza.

Përhapja e islamit në trojet shqiptare erdhi si rezultat i shumë lëvizjeve politike të shek IV.² Për shkak të politikave Lindore dhe Perëndimore të Perandorisë Romake do të bënte të krijoheshin dy grupime politike a). Lindore dhe b). Perëndimore. E thënë ndryshe të krishterët me prejardhje helene dhe asaj me prejardhje latino romane dhe kjo beri që në vitin 1054 të krijoheshin dy ndarje të mëdha a). Kisha Katolike dhe b). Kisha Ortodokse.³

1. Vilajeti i Shkodrës. Deri ne vitin 1878 Vilajeti i Shkodrës kishte: Shkodrën, Tivarin, Podgoricën, Tuzi, Ulqin, Puka, Oroshi, Lezha, Kruja, Tirana, Durrësi, Kavajë etj. Në këtë vit përveç Vilajetit të Shkodrës ishte edhe Vilajeti i Kosovës, Manastirit dhe Janinës.

2. Populli shqiptar, si pasardhës direkt i ilireve dhe nip pellazgjik është bartës i kulturës ballkaniko-mesdhetare parahomerike, se këtejmi edhe mbartës i panteizmit të përvetësuar nga helenet dhe romakët. Panteizmi iliro pellazgjik ishte një mishërim i fenomeneve natyrore me kryepërdinën Zotin, të cilët helenet e quajtën Zeues ndërsa romaket Jupiter, pa ia munguar asnjë tipar. Me fjale të tjera perceptimi i ilireve për një kryeperendi pashmangshëm shpinte në besim monoteist. Në këtë fakt duhet parë një ndër shkaqet e pranimi të krishterimit nga iliret që në fillim të përhapjes, krahas faktit të krishterimit fillimisht ishte fe dhe besim i shtresave të shtypura të shoqërisë skllavopronare romake të etnisë jogreke dhe joromake. Vete fakti se mbreti Kostandin (iliro-dardan) i Romës, ua njohu ilireve, maqedonasve dhe grekëve krishterimin për fe zyrtare. (Dr. Muhamet Pirraku, "Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët" fq.33).

3. Kundërthënia midis dy kishave, të Lindjes dhe të Perëndimit, do të ashpërsohen veçanërisht nga shekulli V. (Dr. Muhamet Pirraku, "Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët" fq.33).

ISLAMI DHE KAZAJA E PUKËS



Ndarja e kishës dhe luhatja e rritit fetar të krishterë në tokat shqiptare ishte goditje e fortë dezintegruese në fushën e integritetit të kulturës dhe të kombësisë shqiptare. Lufta e dy kishave për administrimin e tokave shqiptare luhati fuqishëm besimin e shqiptarëve. Këto politika bënë që të lulëzonin projektet për tjetërsimin etnik të ilireve. Ardhja e Perandorisë Osmane⁴ solli një zhvillim të ri politiko-administrativ. Osmanët nuk krijuan kufi mes njërive administrative të shqiptarëve, por i la që ato të ishin të bashkuar.⁵

Feja islame në trojet Shqiptare filloi të zë vend lirisht dhe me vullnet nga shqiptarët pasi ato ishin të lodhur së mbrojturi nga luftërat gjakatare mes dy kishave.

Gjërat filluan të ndryshonin për mirë për të gjithë ato familje që pranonin islamit. Siguria dhe mirëqenia e tyre u rrit. Kjo bëri që shumë të tjerë ti bashkoheshin islamit dhe jo siç pretendojnë disa që Islami u

4. Fitorja e tërthortë më e madhe për popullin shqiptarë ishte evitimi i kufijve midis viseve nën administratën serbe e greke bizantine që i copëtonte tokat shqiptare... (Dr. Muhamet Pirraku, "Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët" fq.37).


5. Sipas të dhënave ; Osmanët kanë filluar të duken në viset ballkanike rreth vitit 1354.

përhap me dhunë në trojet shqiptare.⁶ Prof.dr. Herman Gross në "Ekonomia Ballkanike" shkruan: "Shqiptarët gjatë pesë shekujve që kanë bashkëjetuar me turqit osmanli, në sajë të aftësive së adaptimit dhe të talenteve të tyre si nëpunës, kishin zënë shkallet më të larta në qeverinë e Stambollit dhe kishin luajtur role të rëndësishme për perandorinë. Mirëpo nga ana tjetër, fiset shqiptare jetonin të lira e të pavarura në malet e Shqipërisë." dhe këtu e ka fjalën për Mirditën, Dukagjinin, Sulin e Himarën.

Rreth viteve 1662⁷, eksploruesi turk Evlija Çelebi vizitoi veriun e Shqipërisë. Sipas të dhënave që ai jep del se në Kazan e Pukës kishte disa familje myslimane madje edhe në drejtim të Kazasë së Pukës me konkretisht Kajmekam.

6. Nuk ka ekzistuar absolutisht asnjë rast kthim feja me dhunë nga ana e turqve "Po ashtu në këtë libër A.Kolaj thotë: "Ndërrimi i fesë së shqiptarëve me anë të dhunës është pjellë e fantazisë dhe shpikja e murgjve dhe nuk është aspak e hijshme që ta pretendojnë këtë historianët." (info, Aristidh Kolaj ish Kryetar i Arbërve që jetojnë në Greqi) (Aristidh Kolaj, "Arvanitët", Athinë 1985) Ndërsa koloneli Lik në librin e tij "Udhëtime nëpër Shqipëri" shkruan: "Shqiptarët bëheshin mysliman sepse kjo fe pajtohej me natyrën e tyre dhe nuk toleronte përluljen, martirizimin, servilizmin dhe ofendimin" viti 1804.

7. Pra flasim këtu e 350 vite më parë.



Të parët që filluan të pranonin Islamit ishin familjet fisnike të Kabashit. Pas vitit 1523 aty numëroheshin të kishte disa familje myslimane. Pas Kabashit filluan përfaqimin e Islamit Puka, Rrape, Qerreti, Kryezi etj. Ishte familja Dizdari në Pukë që pranoi Islamit për t'u ndjekur nga shumë të tjerë.

"Pas shek. XVII në fshatin Kabash feja islame u hap me shpejtësi të madhe. Sipas të dhënave, i pari që pranoi fenë islame në fshatin Kabash ishte Hadër Leka. Nopça shkruan se: Kabashi ka qenë i pari fis i Shqipërisë së Veriut që kaloi në Muhamedanizëm. Pas vitit 1900 Kazaja e Pukës numëronte mbi 700 mysliman".⁸

Pas Kabashit, Pukës, Qerretit filloj të hapej Islami edhe në zonat e tjera si: Rryp, Kryezi, Iballe, Flet, Xathe, Dardhe, Trun, Kulumri etj. Islami filloj të luante një rol të rëndësishëm jo vetëm në jetën e familjeve myslimane por edhe të besimeve të tjera pasi paria e vendit në pikat më kyçe drejtoreshin nga myslimanët. Sipas të dhënave në vitin 1900 Kazaja e Pukës kishte 6.300 banorë mysliman dhe 10.000 katolik. Në librin e tij "Nëpër gjurmët e Islamit", Ali Basha shkruan: "Në Kazanë e Pukës - e quajtur edhe Dukagjin, bëjnë pjesë katër fise. Bajraku i Pukës në vitin 1900 numëronte 700 mysliman - rreth 44% dhe 910 katolik. Ndërsa në vitin 1916

8. Shkrim i përgatitur nga Gëzim Kopani dhe i botuar në revistën shkencore "Zani i Nalt" nr.7, v.2014.

shifra e banorëve mysliman u rrit në 52%. Edhe Kabashi ka qenë i përzier në mënyrë të barabartë 50% me 50%. Në fiset si Kryeziu, Berisha, Qerreti të marra së bashku në vitin 1900 kishte 720 mysliman dhe 780 katolik. Vetëm Kryeziu kishte 670 mysliman".⁹

Zonat si Puka, Kabashi, Qerreti, Kryeziu ishin ndër zonat më të zhvilluara. Në këto zona mund të gjendeshin xhami, kisha, hane, dyqane dhe blegtori të zhvilluar. Vlen të përmendet Panairi i Enëve të fshatit Kabash i cili u zhvillua shumë pas ardhjes së Perandorisë Osmane pasi Shkodra u bë kryeqytet i Shqipërisë. Thuhet se Panairi i Enëve e ka zanafillën e vet rreth shek. XIII. Ai shtrihej në Lam Lushaj Kabash.¹⁰

Kjo traditë vazhdoi deri vonë. Rëndësia që kishte ky panair ishte fakti që në të merrnin pjesë pothuajse të gjitha fshatrat e Pukës, madje edhe të Gjeganit, të Kashnjetit, Lezhës etj. Normalisht nuk mungonin edhe Shkodranët dhe Kosovarët. Në këtë zonë ndodhej Xhamia e Kabashit si dhe Mejtepi i Kabashit. Fakti që panairi i Kabashit u zhvillonte në vendin ku ndodhesh Xhamia e Kabashit tregon për rëndësinë dhe ndikimin që ajo kishte në këtë fshat. Po ashtu vende të rëndësishme zhvillimi ishte edhe Xhamia e Kodër Hanit Pukë, Qerreti, Kryeziu etj.

9. Ali Basha, "Në gjurmët e Islamit" fq.504.
10. Në Lam Lushaj ndodhet edhe rruga e vjetër që quhej rruga e karvanëve.



"Islami është fabrikë e madhe, ku përpunohen burrat! Islami ka derdhur heroizmin në çdo nerv të muslimanit, e ka bërë atë të qarkullojë në gjakun e tij... Prandaj, sado që muslimanët rrethohen nga vështirësitë dhe sprovat, kurrë nuk do të ndryshojë natyra e heroit ndër ta! E ardhmja do të jetë e tyrja, nëse do të jenë me All-llahun!"

Sheikh Ali Basha



Idmir Plaku
imam, xhamia "Ebu Bekër"

Haxhi një nga pesë shtyllat e Islamit. Një obligim për kryerjen e të cilit, në zemrën e çdo besimtari ka një ndjesi të veçantë.

Kjo ndjesi besimi shtohet nga viti në vit tek besimtarët kudo që ata ndodhen. Meqënëse shumë besimtarë e kanë të pamundur ta kryejnë këtë obligim ndaj Allahut (xh.sh), e aq më shumë për të qenë të pranishëm çdo vit në vendet e shenjta, Pejgamberi (a.s) i ka nxitur besimtarët për të bërë punë të mira. Vepra alternative të mira që kanë vlerën e haxhit apo umres, në pamundësi të tyre. Me këto vepra besimtarët që nuk kanë mundësi për të bërë haxhin i afrohen Allahut (xh.sh) me ndjesinë e besimit në zemrat e tyre.

Ndër këto vepra të mira përmendim :

1- Tesbih-Tahmid-Tekbir, pas çdo namazi.

Transmetohet se muhaxhirët e varfër erdhën tek Pejgamberi (a.s) dhe i thanë: Të pasurit na e tejkaluan në grada të larta dhe kënaqësitë e amshueshme. Pejgamberi (a.s) i pyeti: "Si kështu?" Thanë: Falen sikurse edhe ne, agjërojnë sikurse edhe ne, japin sadaka e ne nuk japim dot, lirojnë robër e ne nuk lirojmë dot. Pejgamberi (a.s) u tha: "A doni t'ju mësoj diçka me të cilin do të arrini ata që ju kanë tejkaluar dhe t'i kaloni ata që janë prapa jush dhe askush nuk do të jetë më i mirë se ju, përveç atij që vepron njësoj sikurse edhe ju?" Thanë: Po, o Dërguari i Allahut! U tha: "Të thoni tridhjet e tri herë "Subhanallah, Elhamdulillah dhe All-llahu ekber" dhe pastaj përmbyllni me fjalët: "La ilahe il-a llah".¹ E kjo është e njëqindta herë

1. Muttefekun alejh.

VEPRA TË MIRA NË PAMUNDËSI TË HAXHIT DHE UMRES

"A doni t'ju mësoj diçka me të cilin do të arrini ata që ju kanë tejkaluar dhe t'i kaloni ata që janë prapa jush dhe askush nuk do të jetë më i mirë se ju, përveç atij që vepron njësoj sikurse edhe ju?"

më e mirë se dynjaja". Hasani El-Basri ka thënë: "Nëse ndonjë person e shikon duke bërë konkurrencë në dynja, thuajti konkurro për gjërat e ahiretit se të bën dobi."

2- Dhikri, Përkujtimi i Allahut në vazhdimësi.

Ebu Darda (r.a) thotë se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: "A doni t'ju tregoj për veprat më të mira e më bujare te Zoti juaj, të cilat jua lartësojnë më së shumti shkallën dhe janë më të mira sesa shpenzimi i arit dhe i argjendit dhe më të mira për ju sesa përleshja me armikun tuaj në të cilën do t'i vrisnit ose ata do t'ju vrisnin juve?" Po, duam, thanë ata. Ai tha: "Dhikrulllahi, Përkujtimi i Allahut."²

3- Namazi i sabahut me xhematë dhe dhikri pas tij.

Enes ibn Maliku (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush falë sabahun me xhemat pastaj qëndron duke bërë dhikër deri në lindjen e diellit dhe më pas i fal dy rekatë, do të ketë shpërblim sikurse të ketë kryer haxhin dhe umren të plotë, të plotë, të plotë."³

4- Falja e pesë kohëve të namazit dhe namazit të duhasë.

Ebu Umame (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush del nga shtëpia i pastër, me qëllim për të falur pesë kohët e namazit, shpërblimi i tij është sikurse i haxhiut, i veshur me ihram, e kush del me qëllim të vetëm për të falur namazin e duhasë shpërblimi i tij është sikur atij që bën umre, dhe namazi pas namazit që pritet për t'u falur, i pashoqëruar me biseda pa vlerë mes tyre, është libër në Il-lij'jinë."⁴

5- Mirësjellja ndaj nënës.

Nga Enesi (r.a) transmetohet se

2. Ahmedi, Tirmidhiu, i cili ka thënë është i saktë.
3. Tirmidhiu, ka thënë "hasen-i mirë".
4. Ebu Davudi, "hasen-i mirë".

*"KUSH FALË
SABAHUN ME XHEMAT
PASTAJ QËNDRON DUKE
BËRË DHIKËR
DERI NË LINDJEN
E DIELLIT DHE MË PAS I FAL
DY REKATË, DO TË KETË
SHPËRBLIM SIKURSE
TË KETË KRYER HAXHIN
DHE UMREN TË PLOTË,
TË PLOTË, TË PLOTË"*

Pejgamberi (a.s) porositi një burrë me sjelljen e mirë ndaj nënës dhe i tha: "Ti je haxhi, vizitor (mu'temir), muxhahid"⁵, duke lënë të nënkuptohet, nëse sillet mirë ndaj saj.

6- Kryerja e detyrimeve ndaj besimtarit.

Kryerja e obligimeve për besimtarin është një mirësi e madhe. Robi afrohet tek Allahu (xh.sh) më shumë me kryerjen e obligimeve, sesa me ato vepra që janë vullnetare. Haxhi i pranuar është një lindje e dytë e pastërtisë ndaj mëkatit për besimtarin. Në pamundësi të kryerjes së haxhit, apo umres, Pejgamberi (a.s) na udhëzoi në vepra të mira të tjera që e afrojnë besimtarin tek Allahu (xh.sh), me po aq pastërti prej mëkateve, shpërblim të madh sa haxhi apo umreja. Këto vepra e bëjnë besimtarin të ndjejë përherë ndjesinë e të qenurit në haxh, të vizituarit e Qabes së Madhnueshme me ndjesinë e zemrës.

5. Tabaraniu.



Naim Drija
imam, xhamia Parrucë

Allahu (xh.sh) thotë: "Për hir të Allahut, vizita e Qabes është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo...".¹ Fjala "mundësi" nënkupton sigurimin e mjeteve të transportit, të ushqimit dhe i të gjitha mjeteve të tjera që janë të nevojshme për të shkuar në Qabe. Ajo nuk ka dyshim se përfshin edhe shëndet të mirë që të përballohet kryerja e haxhit edhe mundësi ekonomike. Ndërsa në një ajet tjetër Zoti (xh.sh) thotë: "Kryejeni haxhin dhe umren për hir të Allahut...".²

Haxhi është një prej pesë kushteve të Islamit, Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s) është rob dhe i dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit."³

URTËSIA E LIGJËRIMIT TË HAXHIT

1. Përmirësimi i zemrës: Udhëtimi i Haxhit dhe Umres mbjell në zemrën e besimtarit kuptimin e vërtetë të "ikjes" për tek Allahu. Besimtari lë shtëpinë, familjen, pasurinë, punën dhe vendin e tij, shpenzon shumën më të madhe të parave për të vizituar Shtëpinë e Shenjtë, pra për të fituar kënaqësinë e Allahut. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Haxhilerët janë mysafirët e Allahut, nësi i luten, Ai i përgjigjet, e nëse kërkojnë falje, Allahu i falë."⁴

2. Manifestimi i vëllazërisë dhe paqes: Ky udhëtim përforcon edhe më shumë vëllazërinë islame. Të gjithë muslimanët pa dallim rracash, ngjyrash, postesh, apo pozitash mblidhen në

1. Kur'ani, Ali Imran: 97.
2. Kur'ani, Bekare: 196.
3. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
4. Transmetuar nga Ibn Maxhe.

KUSH DËSHIRON TA KRYEJË HAXHIN, LE TË SHPEJTOJË!

një vend të vetëm dhe në një kohë të vetme. Ajo është një zonë sigurie dhe paqeje, e rrallë në llojin e saj, që ka përfshirë edhe zogjtë në qiell, gjahun në fushë dhe bimët në tokë. Në këtë zonë nuk duhet të gjuhet gjahu, nuk duhet të tremben as zogjtë dhe as kafshët e saj dhe aty nuk priten e nuk dëmtohen as pemët e as bimët e saj! Omeri (r.a) ka thënë: "Nëse aty do të gjeja edhe vrasësin e babait tim, nuk do ta prekja fare me dorë."⁵

3. Haxhi është nxitje për përparim dhe zhvillim: Kryerja e haxhit është një nxitje e hapur, për të fituar me hallall dhe për të mbledhur pasuri. Dihet se shpenzimet për këtë detyrë nuk janë të pakta, prandaj muslimani duhet të punojë sa më shumë. Në këtë mënyrë ai bëhet element zhvillimi për vendin e tij.

4. Gucimi dhe sakrifica: Allahu i Madhëruar thotë: "Thirri njerëzit për në haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me mjete prej të gjitha viseve të largëta".⁶ Muslimani i cili largohet nga atdheu i tij për të vizituar Shtëpinë e Shenjtë, ka guxim të madh dhe ky është argument, se ai ka marrë përsipër të sakrifikojë gjithçka për të realizuar thirrjen e Krijuesit të tij.

5. Adhurimi me ndikimin më të madh në jetë që përfshin në vetvete të gjitha llojet dhe format e adhurimeve. (Pra ai përfshin adhurimin me zemër, me trup (fizikisht) dhe me pasuri....): Në Haxh thuhet Telbija, që është njësimi i Allahut, duke realizuar kështu shtyllën e parë të Islamit. Në Haxh falet namazi dhe bëhen dua, duke realizuar kështu shtyllën e dytë të Islamit. Në Haxh shpenzohet dhe ushqehen të varfërit (jepet Zekat dhe sadaka), duke realizuar kështu shtyllën e tretë të Islamit. Në Haxh besimtari tregohet i matur, duke u larguar nga sharjet, grindjet dhe debatet (gjëra që kërkojnë të shmangen në agjërim), duke realizuar kështu shtyllën e katërt të Islamit. Gjithashtu Haxhi ka ritet e tij të veçanta si: Ihrami, Tavafi, Saji, qëndrimi në Arafat etj. Ky adhurim ka vështirësi dhe mundime, prandaj me të drejtë është quajtur adhurimi i jetës.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Umreja deri në umren tjetër i shlyen gjynahet që janë bërë mes tyre, kurse për haxhxhin e pranuar shpërblimi i vetëm i tij është xhenneti."⁷

DISA NGA OBJEKTIVAT E HAXHIT

1. Realizimi i nënshtimit vetëm ndaj Allahut dhe zbatimit të urdhërit të Tij, pasi haxhi ka vepra dhe fjalë, me të cilat madhërohet Allahu, lartësohen simbolet e Tij dhe zbatohen urdhërat e Tij.

2. Realizimi i barazisë, bashkimit dhe forcës.

3. Përfjetimi sadopak i gjendjes në ditën e Mahsherit, llogarisë, ndarjes nga njerëzit, familjarët dhe pasuria.

4. Manifestimi i vëllazërisë dhe bashkimit, zhdukja e racizmit dhe paragjytimeve, krijimi i modelit të bashkëjetesës me atë që ka mendim ndryshe.

5. Haxhi e lidh besimtarin me tokën ku u lind Profeti (a.s) dhe i kujton atij ngjarje plot kuptim që kaloi Ai.

Amr ibn el-Asi (r.a) tregon: "Kur Allahu më udhëzoi në Islam, shkova tek Profeti (a.s) dhe i thashë: "O i Dërguari i Allahut! Ma jep dorën që të të jap besën". Profeti (a.s) e zgjati dorën e tij por unë e tërhoqa timen. Atëherë më pyeti: "O Amr, Si e ke hallin?" Unë i thashë: "Kam dëshirë të bëj një kusht". "E cili është kushti yt", pyeti Profeti (a.s). "Që të më falen të gjitha gjynahet e kaluara", i thashë. Atëherë Profeti (a.s) më tha: "O Amr! A nuk e di se përqaftimi i Islamit i fshin të gjitha gjynahet e mëparshme; se hixhreti i fshin të gjitha gjynahet dhe se kryerja e haxhit i fshin të gjitha gjynahet?"⁸

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush dëshiron ta kryejë haxhin, le të shpejtojë."⁹

Profeti (a.s) ka thënë: "Kush e kryen haxhin vetëm për hir të Allahut dhe gjatë tij nuk flet fjalë të fëlliqura dhe nuk bën gjynahe, kthehet nga haxhi si ditën që ka lindur."¹⁰

7. Transmetuar nga Buhariu.
8. Transmetuar nga Muslimi.
9. Transmetuar nga Ahmedi, Ebu Davudi, Hakimi dhe Bejhëkiu.
10. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

PËRGATITJET PËR HAXH, KËSHILLA PËR HAXHILERËT

Në fund të këtij muaji dhe fillimit të shtatorit rrugës për në Meke do të nisen haxhinjtë tanë. Ky është udhëtimi më i dashur dhe më i rëndësishëm për çdo musliman. Për këtë udhëtim përgatiten dhe ëndërrojnë me vite. Disa kanë fat që disa herë ta vizitojnë Qabenë, ndërsa disa shkojnë në Botën tjetër me këtë dëshirë.

Me përvojën dhe modestinë time dëshiroj që haxhinjtë tanë të dashur t'u jap disa këshilla. Veçanërisht dëshiroj të përmend disa mesazhe të fshehta të haxhit që na i mëson imami madh Ebu Hamid El-Gazali, Zoti i mëshiroftë, i cili ka thënë se asgjë nuk e përkujton vdekjen ashtu siç e përkujton udhëtimi i haxhit.

Është e ditur se haxhin e kanë obligim ata muslimanë që kanë mundësi materiale për këtë udhëtim të bekuar. Gjëja kryesore është që pasuria me të cilën udhëtohet për në haxh duhet të jetë pasuri e fituar hallall, në të kundërtën njeriu vë në pikëpyetje vlefshmërinë e haxhit të tij. Kur haxhiu me telbijen thërret Zotin e tij duke thënë Lebbejkall-llahumme – të përgjigjem ty o Zot”, dhe nëse njeriu në haxh ka shkuar me pasuri haram, mund të marr përgjigjen e Allahut: “Nuk je përgjigjur ti, rob i Im!

Kur njeriu të paraqes udhëtimin e tij për në haxh, ndërsa njerëzit fillojnë ta vizitojnë për të marrë hallallëkun dhe të ndajnë gëzimin me të për këtë udhëtim të largët, haxhiu duhet të jetë i zënë me falënderime ndaj Allahut të Madhërishëm për begatinë e jetës, shëndetit dhe pasurisë që i është dhënë. Sepse ai është nga të rrallët që i është mundësuar vizita e Qabesë.

Kur të vijë koha të përshëndetet me familjen, fqinjët dhe miqtë, dhe kur ata të fillojnë të qajnë për ndarjen e tij gjatë këtij udhëtimi, le t'i shkoj mendja tek çasti kur të vdekurin e marrin nga shtëpia e tij dhe fillojnë të qajnë për të.

Kur të ulet në mjetin transportues, le t'i shkoj mendja tek mjeti i ahiretit – tabuti, me të cilën do të udhëtoj për në shtëpinë e ahiretit. Gjatë udhëimit për në haxh duhet ta përmend shumë Allahun, të bëj dua, të lexoj Kuran dhe të dërgoj salavate ndaj Pejgamberit (a.s) dhe le të largohet nga fjalët e kota. Gjithmonë duhet të jetë në ndihmë të



bashkudhëtarëve të tij dhe të jetë i durueshëm për veprimet e tyre të pamatura. Haxhiu duhet të ruhet nga gjynahet dhe të jetë i devotshëm sepse ky është furnizimi më i mirë për haxh. Nëse vërtetë është nisur të jetë mysafir i Allahut, nuk i ngjanë të bëj gjynahe.

Kur të arrij në Mikat – vendi ku hiqen rrobat e dynjasë dhe vishen rrobat e haxhit – Ihramet, në vendin kur para se të vishen me ihrame, haxhinjtë pastrohen, le të mendoj kur të vdekurit i hiqen rrobat e dynjasë dhe e pastrojnë, pastaj i veshin rrobën e ahiretit. Kur t'i vesh ihramet që përbëhen nga dy çarçafë sikur janë edhe qefinët, duhet të rruhet edhe më shumë nga gjynahet, të thotë sa më shumë telbijen dhe tekbiert, kështu e falënderon dhe madhëron Allahun i Cili ia mundësoi këtë udhëtim.

Kur të hyjë në haremin e Qabesë, le të hyjë nga dera “Selam” duke lutur Allahun që ta fus në xhenet me selamin. Kur ta shoh Qabenë, shtëpinë e Allahut, le të mendoj momentin e shikimit të Allahut në Ditën e Gjykimit. Kur ta bëj tavafin rreth Qabesë t'i shkojë në mend se gjendet në vendin më të zgjedhur dhe më të dashur për Allahun. Gjithashtu të mendoj se në atë vend ku ai është dhe bën tavaf, janë përqendruar numri më i madh i evlijave të Allahut. Le të mendoj për atë se ai është nga ata fatlumë ku ec në vendet ku kanë ecur të Dërguarit e Allahut dhe mes tyre edhe i Dërguari ynë Muhamedi (a.s)

Derisa bën tavafin rreth Qabesë së tokës, ta dijë se në ato momente 70 mijë melek që asnjëherë nuk vijnë përsëri në rend, bëjnë tavaf rreth Qabesë së qiellit – Bejtul Ma'mur.

Kur të afrohet Haxherul Esvedit

– gurit të zi, le të turpërohet për gjynahet e tij dhe le të kujtoj fjalët e Alejhiselamit i cili ka thënë se ai gurë ka ardhur nga xheneti dhe ka qenë i bardhë si qumështi, por me preken e duarve gjunahqare dhe puthjes nga buzët mëkatore është nxirë.

Kur ta bëj s'ajin – ecjen e shpejtë mes kodrave Saffa dhe Merva, le të kujtoj hazreti Haxheren dhe vështirësitë e saja si dhe vështirësitë me të cilat njerëzit do të përballen në Ditën e Gjykimit. Kur atë arrij në Arafat – kodrën e mëshirës së Allahut, gjuha e haxhiut duhet të jetë e zënë më dhikr dhe kërkim falje. Le të kërkoj falje për veten familjen, farefisn, miqtë dhe gjithë ymetin.

Qëndrimi në Arafat duhet t'ia përkujtoj qëndrimin në Ditën e Gjykimit, ndërsa afrimi në grupe i haxhinjtë me imamët e tyre, le t'ia përkujtoj imamët me të cilët do të ringjallet dhe do të dalën para të Madhërishmit. Kur të vij në Muzdelife le ta falënderoj Allahun që e udhëzoi në Rugën e Islamit dhe që ia mundësoi të kthehet në shtëpi i pastruar nga mëkatet ashtu siç e lindi nëna.

Ardhja në Mine dhe gjuajtja e shejtanit, le t'ia përkujtoj vendosmërinë e Ibrahimit dhe Ismailit në kryerjen e amanetit dhënë Zotit. Ashtu siç këto dy Pejgamber pamundësuan ndikimin e shejtanit, edhe haxhiu në atë vend të betohet se në të ardhmen do ta dëgjoj Allahun dhe do të injoroj shejtantin e mallkuar.

Lus Zotin të ndihmoj çdo haxhi që me zemër të sinqertë dëshiron të arrij mirësitë e haxhit dhe faljen e Allahut të Madhërishëm.

(Islampress.info)



Ervil Kuçi, teolog

Allahu (xh.sh) e krijoi njeriun në formën më të përsosur dhe e bëri atë mëkëmbësin e Tij në tokë, dhe i dhuroi begati dhe mirësi nga mirësitë e Tij të pafundme.

Por, mirësia më e madhe, e cila përfshin të gjitha begatitë dhe mirësitë e Tij, është mirësia e besimit.

Ajo është një mirësi, që luan rolin e busullës në jetën e njeriut. Atij që Allahu (xh.sh) i do të mirën, i jep besimin dhe kujt i jepet mirësia e besimit, i është dhënë mirësi e madhe në këtë botë dhe në jetën e përtejme.

Falë mirësisë së besimit kemi njohur Zotin tonë, madhështinë dhe cilësitë e Tij. Kemi njohur argumentet e Tij të pafundme në çdo gjë që ka krijuar dhe pasi e kemi njohur Atë, e kemi besuar dhe pasi e kemi besuar e kemi dashur dhe i jemi nënshtruar plotësisht me bindje, duke jetuar sipas udhëzimeve që ka urdhëruar dhe duke iu shmangur ndalesave të Tij.

Mirësia e besimit është ajo, që të tregon se deri dje ishe i vdekur në mesin e të gjallëve, sepse nuk ia dije vlerën mirësive që të janë dhuruar, edhe pse i kishe përpara syve tuaj çdo ditë të jetës tënde. I shijoje dhe i gëzoheshe

MIRËSIA E BESIMIT...

“O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”

atyre mirësive pa pyetur ndonjëherë a i meritoje? Apo, kush t'i dha? Ose, kujt i detyrohesh mirënjohje për çdo gjë që posedoje? I vdekur në mesin e të gjallëve, sepse zemra ishte tepër e ngurtë nga neglizhenca, apo arroganca për t'i qenë mirënjohës Atij që të dha çdo gjë.

Ndërsa sot, i gjallë... I gjallë sepse Zoti të hapi dyert e mirësisë edhe njëherë, duke të dhënë mundësi ta njohësh madhështinë e Tij në çdo aspekt të jetës... I gjallë sepse sot, e di mirë se kujt i detyrohesh mirënjohje dhe përulje për çdo gjë që posedon... I gjallë sepse je i bindur në zemrën tënde se mirënjohja jote ndaj Tij të ka dhuruar kënaqësinë e Tij... I gjallë sepse në shumë momente të jetës, kur shikon mirësitë e Zotit tënd, thellë në zemrën tënde nuk mbetet gjë tjetër për të thënë, veçse falënderimi, që i shkon një besimtari të vërtetë: “O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” - (En-Neml: 19)

Mirësia e besimit është ajo, e cila mbush zemrën e njeriut me optimizëm dhe shpresë edhe atëherë kur ai sprovohet me ndonjë fatkeqësi, sëmundje ose varfëri, sepse falë besimit në Atë të Cilin i dha kuptim jetës së çdo


krijese, besimtari është i bindur se çdo gjë ndodh me dijen e Tij, dhe Ai i cili i solli atë sprovë, vetëm Ai mund t'ia heqë këtë sprovë, është i bindur në atë që ka premtuar Zoti i Gjithësisë në Librin e Tij fisnik: “Me të vërtetë mbas vështirësisë vjen lehtësimi.” - (Inshirah: 5)

Kurse Pejgamberi (a.s) e përshkruan në këtë mënyrë çështjen e besimit, sesi e përjeton dhe e vlerëson ai mirësinë e besimit, si në rehati e begati ashtu si edhe në sprovë e vështirësi: “Çështja e besimit është e habitshme dhe, në fakt e gjithë çështja e tij është mirësi. Kjo nuk i ndodh askujt tjetër, përveç besimitarit. Nëse i vjen një e mirë falënderon dhe kjo është mirë për të, e nëse e godet ndonjë e keqe duron dhe kjo është mirë për të.”

Besimi për njeriun është mburojë nga veset, paranojat, zhgënjimet, dështimet. Mburojë ndaj vetëpëlqimit, arrogancës, mosmirënjohjes, degradimit, shthurjes dhe jep shpresë e optimizëm se, me besimin në Zotin e Gjithësisë që ka në dorë çdo gjë, besimtari bie në paqe me veten e tij, i hapë dyert e durimit dhe shpresës në çdo sprovë, i hapë dyert e të qënurit falënderues dhe mirënjohës për çdo mirësi dhe begati.

Falënderimet dhe mirënjohja i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar për mirësinë e besimit.

Atij i lutem që të na bëjë gjithmonë mirënjohës për mirësitë dhe begatitë e pafundme, që na ka dhuruar. Amin!



Ditën e hënë, më 8 gusht 2016, qytetin e Shkodrës e vizitoi një delegacion i “Bejtuz-Zekat”, institucion i njohur bamirës në Shtetin e Kuvajtit, që zbaton projekte të shumta në mbarë botën.

Në krye të delegacionit ishte z. Adil El-Xheri, Drejtor i Zyrës për Veprimtarinë me Jashtë në “Bejtuz-Zekat”, që shoqërohej nga z. Korab Kaja, Drejtor i Fondacionit “Mirësia”.

Gjatë vizitës në Shkodër, z. El-Xheri, u prit edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, me të cilin diskutoi rreth projekteve të mundshme për t’u realizuar në Shkodër.

Nga ana e tij, Myftiu e njohu mikun nga Kuvajti me zhvillimet e dekadave të fundit në Shkodër dhe politikën selektive në investime, me të cilat është përballur qyteti dhe zonat muslimane në veçanti. Myftiu e informoi z. El-Xheri, edhe me disa prej projekteve me rëndësi, që Myftinia Shkodër është e interesuar të realizojë dhe për të cilat lobon prej kohësh.



Nga ana e tij, z. El-Xheri premtoi se do të angazhohet maksimalisht që “Bejtuz-Zekat” të investojë në drejtim të realizimit të projekteve të ndryshme në Shkodër e Shqipëri, si pjesë e partneritetit në rritje.

Më herët, ai vizitoi edhe xhaminë e

re, që po ndërtohet në Krye-Bushat, si investim bamirës nga Shteti i Kuvajtit, me ndërmjetësinë dhe angazhimin e lavdëruar të Fondacionit “Mirësia”.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe.

“BEJTUZ-ZEKAT” E KUVAJTIT, INTERESIM PËR SHKODRËN

MYFTIU PRITI IMAMIN E QENDRËS ISLAME SHQIPTARE “EL-BUHARI”, VJENË

Ditën e martë, më 16 gusht 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, teologun Daud (Taulant) Kurtabegu, Imam i Qendrës Islame Shqiptare “El-Buhari”, në Vjenë të Austrisë.

Gjatë bashkëbisedimit të ngrohtë, Myftiu e falënderoi z. Kurtabegu për kontributin e vyer të Qendrës Islame Shqiptare “El-Buhari”, sidomos për bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës, gjatë muajit Ramazan, në disa projekte të dobishme social-kulturore.

Nga ana e tij, teologu Daud Kurtabegu, shprehu falënderimet e tij për komunikimin vëllazëror dhe gatishmërinë e Myftinisë Shkodër për bashkëpunim, duke theksuar se urat e bashkëpunimeve janë përherë tregues të rritjes së komunikimit në mesin e muslimanëve.



Dy bashkëbiseduesit diskutuan edhe për botimet e ndryshme dhe nevojën e shfrytëzimit të rrethanave aktuale të zhvillimeve të reja të qytetit, për prezantimin sa më bashkëkohor të mendimit islam nëpërmjet botimeve

të dobishme.

Me këtë rast, Myftiu e ftoi teologun Daud Kurtabegu, që ditën e enjte, më 18 gusht 2016, pas namazit të akshamit, të mbajë një ligjëratë, në kuadër të një tribune fetare në xhaminë e Parrucës.

Ditën e mërkure, më 24 gusht 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi në terren punimet që po kryhen për ndërtimin e minares së re në xhaminë e zonës Fshati i Ri, Postribë.

Myftiu shprehu kënaqësinë e tij për mirësinë e madhe, plotësimin e kësaj xhamie të re në moshë, me minaren e munguar prej vitesh.

Ai shprehu mirënjohjen e tij për kontribuuesen e kësaj vepre të dëshmuar, një motër muslimane nga Shkodra, e cila u afrua vullnetarisht për të dhënë nga pasuria e saj në shërbim të këtij projekti të domosdoshëm për vetë imazhin e xhamisë, por edhe për krejt zonën.

Ndërtimi i minares së re, do ta plotësojë më së miri hartën e xhamive të zonës Postribë dhe Rrethina, ku tashmë spikasin minaret e xhamive: Bardhaj, Mes-Myselim, Vilëz, Domën, Boks, Dragoç, Kullaj dhe së shpejti edhe minarja e Fshatit të Ri.

FSHATI I RI, NË RRUGË TË MBARË MINARJA E RE E XHAMISË



Myftinia Shkodër fton donatorët dhe bamirësit e ndryshëm muslimanë të vazhdojnë të japin nga pasuria, me të



cilën janë begatuar, pasi xhami të tjera presin ndërhyrje të domosdoshme, si: në Milan-Rrasek, Drisht etj.

NISI TRAJNIMI I HAXHILERËVE SHKODRANË PËR VITIN 1437 H.



Ditën e mërkurë, më 24 gusht 2016, Myftinia Shkodër nisi trajnimin e grupit prej 37 vetave nga qyteti i Shkodrës, që janë regjistruar për haxhin e këtij viti.

Sikurse edhe vitet e tjera, edhe këtë vit, të regjistruarve për kryerjen e haxhit, u mundësohet një trajnim profesional, ku të gjithë marrin mësimet e duhura për kryerjen e saktë të ritualeve të haxhit.

Në takimin e parë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi uroi

të pranishmit për mirësinë e madhe të Zotit ndaj tyre, regjistrimin për të shkuar këtë vit drejt vendeve të shenjta për kryerjen e haxhit, tha se kjo mirësi e madhe duhet shfrytëzuar si një mundësi paqtimi dhe afrimi me Zotin, si dhe si një bekim nga Zoti i gjithësisë për gjithësecilin prej tyre.

Myftiu i informoi të regjistruarit, se murshid i grupit të tyre për këtë vit do të jetë teologu Ruzhdi Plangaj, si dhe teologjia Ferzet Ndoja, që do të jetë në ndihmë të motrave të pranishme në grupin e Shkodrës.

Në ditën e parë, dy murshidët e grupit zhvilluan mësimet dhe udhëzimet e para që lidhen me kryerjen e haxhit, rregullat e tij, ndalesat, gjërat e pëlqyeshme, lutjet dhe dhikret etj.

Trajnimi do të vazhdojë për tre ditë dhe në përfundim të tij, pritet të zhvillohet edhe ceremonia e përvitshme e përshëndetjes me haxhilerët e këtij viti, ku besimtarët mblidhen për të uruar pjestarët e grupit të Shkodrës dhe për të kërkuar prej tyre lutje në vendet e shenjta, në Mekë dhe Medinë.



"Çdo njeri është gabimtar dhe nuk ka imunitet në gabime, veçse për Pejgamberët. Kështu që, gabimi në hak të vëllait mund të ndodhë, por nuk korrigjohet gabimi me gabim. Ai korrigjohet me atë ilaç, siç e ka përkshkruar All-llahu, duke thënë:

**"TË KEQEN KTHEJE NË MËNYRËN
MË TË MIRË, SEPSE NË MES TEJE
DHE ATIJ QË KE ARMIQËSI,
MUND TË BËHET
MIQËSI E NGUSHTË."**

(Kur'ani, Fussilet: 34)



Shejki Ahmed Raxhik - Damask

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org